



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:145223

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05732873

C.nr. 532/20

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË - departamenti i përgjithshëm – divizioni civil me gjyqtar Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit B.K e S me seli ne P, i autorizuari B. H, kundër të paditurit F. R. Rr nga fsh. D, me padi për rimbursim te dëmit material, më datë 23.05.2024, mori, ndërsa me datën 24.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M
-Për shkak të mungesës-

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses B. K e S

II . Obligohet i padituri F. R nga fsh. D, që paditëses BKS me seli ne P, ti kompensoi shumën prej 4.255,00 € me kamat sipas mjeteve të deponuara në banka afariste mbi një vite, pa destinim të caktuar duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës taksen gjyqësore në shumë 40€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi BKS ne P, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit F. Rr nga fsh. D, për kompensim të dëmit në vlerë 4.255,00 €.

Gjykata ka caktuar seancë me datën 23.02.2024, në seancë ka prezantuar vetëm i autorizuari paditësit , i cila ka kërkuar nxjerrjen e aktgjykimit në bazë të mungesës.

Gjykata të paditurit ia ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi me datën 17.01.2021 të cilit ia ka bashkangjitur padinë dhe provat materiale të bashkangjitura asaj.

Gjykata në seancë gjyqësore ka gjetur se: I padituri brenda afatin ligjor prej 15 ditësh nuk ka parashtruar përgjigje në padi, nuk ka kontestuar kërkesëpadinë, themelësia e kërkesë padisë del nga provat e bashkangjitura padisë, faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga paditësi si raporti policor i aksidentit 2019-GR-0064 të dt. 06.02.2019, konfrimimi i policës siguroese, ujdia jashtë gjyqësore e datës 11.03.2019 ,urdhër transferi bankar i dt.21.03.2019

Andaj gjykata duke u bazuar në Nenin 151 paragrafi 1të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në Nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:145224 të dt. 24.05.2024**

G j y q t a r i

Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:145223
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05732873